

Bebras Challenge 2024

Rreth Bebras

Bebras Computing Challenge (Kastori i Informatikës) është një iniciativë ndërkombëtare që synon të promovojë informatikën dhe të menduarit kompjuterik ndër nxënësit. Sfida ndihmon nxënësit të eksplorojnë talentet dhe pasionin e tyre për informatikën përmes zgjidhjes së enigmave atraktive dhe sfiduese.

Qëllimi i Bebras Computing Challenge

- Të emocionojë nxënësit për menduarit algoritmik dhe kompjuterik.
- Të kultivojë kreativitetin, aftësitë e arsytimit logjik dhe menduarit algoritmik.
- Të prezantohet menduarit kompjuterik si aftësi themelore e shekullit të 21-të.
- Të ndihmojë në zgjidhjen e problemeve të përditshme duke shfrytëzuar fuqinë e teknologjisë.
- Të inkurajojë përdorimin e teknologjisë në mësim dhe të nxisë nxënësit të angazhohen më shumë në shkenca kompjuterike.

Si funksionon sfida dhe kush mund të përfshihet në këtë iniciativë ndërkombëtare?

Në sfidën Bebras përfshihen nxënësit nga mosha 8 deri në 18 vjeç të cilët zgjidhin një sërë detyrash që mbulojnë tema nga fusha e informatikës dhe menduarit kompjuterik. Nxënësit kanë 35 minuta për të përfunduar sfidën.

Kategoritë e sfidës:

- **Kastorët** (8-10 vjeç)
- **Benjaminët** (10-12 vjeç)
- **Kadetët** (12-14 vjeç)
- **Juniorët** (14-16 vjeç)
- **Seniorët** (16-18 vjeç)

Secila kategori ka nga 9 detyra, të ndara në tri nivele të ndryshme (lehtë-mesatare-vështirë) me nga 3 detyra për secilin nivel. Numri total i pikëve që mund të arrihet në Bebras Computing Challenge është 81.

Sfida kryhet në shkolla duke përdorur kompjuterë. Nxënësit pjesëmarrës mbikëqyren nga mësimdhënësit/koordinatorët e sfidës në nivel shkolle.

Rekomandohet që nxënësit pjesëmarrës në sfidë të përzgjedhen në mënyrë vullnetare nga grupmosha përkatëse, p.sh. nxënësit e paraleleve të klasëve të III-ta dhe të IV-ta formojnë një grup prej 25 pjesëmarrësve për këtë sfidë në nivelin “Kastorët”.

Certifikatat

Për të gjithë pjesëmarrësit do të shpërndahen certifikata të pjesëmarrjes dhe online badges.

Certifikata	Pikët
<i>Bebras Certificate of Participation</i>	≤ 40
<i>Bebras Certificate of Merit</i>	41-50
<i>Bebras Certificate of Excellence</i>	51-60
<i>Bebras Innovator Certificate</i>	61-67
<i>Bebras Pinnacle Certificate</i>	68-79
<i>Bebras Mastermind Certificate</i>	80-81

Bebras Certificate of Participation (≤ 40 Pikë): Kjo certifikatë njihet për përpjekjen e bërë nga pjesëmarrësit, ku shërben si një njohje e angazhimit fillestar të një pjesëmarrësi në mendimin kompjuterik dhe zgjidhjen e problemeve.

Bebras Certificate of Merit (41-50 Pikë): Kjo certifikatë u jepet pjesëmarrësve që kanë demonstruar një kuptim themelor të menduarit kompjuterik dhe shërben për të njohur aftësitë e mësipërme bazë dhe inkurajon pjesëmarrësit që të vazhdojnë të përmirësojnë aftësitë e tyre.

Bebras Certificate of Excellence (51-60 Pikë): Kjo certifikatë u jepet pjesëmarrësve që kanë treguar një zotërim të shkëlqyeshëm të shkathtësive të menduarit kompjuterik dhe zgjidhjes së problemeve. Certifikata është krijuar për të lavdëruar një grup të fortë shkathtësish dhe për të inkurajuar eksplorimin dhe studimin e mëtejshëm në këtë fushë.

Bebras Innovator Certificate (61-67 Pikë): Kjo certifikatë është e rezervuar për ata që kanë shfaqur mendim inovativ dhe shkathtësi të avancuara për zgjidhjen e problemeve. Marrësit e kësaj certifikate konsiderohen të pajisur mirë për të përballuar sfidat komplekse dhe për të kontribuar në zgjidhje shpikëse.

Bebras Pinnacle Certificate (68-79 Pikë): Kjo certifikatë u jepet shënuesve më të mirë, kjo certifikatë është një mirënjohje e arritjeve të jashtëzakonshme në të menduarit kompjuterik. Marrësit e kësaj certifikate kanë demonstruar një nivel elitare shkathtësish dhe konsiderohen ndër më të mirët e grupit pjesëmarrës.

Bebras Mastermind Certificate (80-81 Pikë): Ky është niveli më i lartë i njohjes, i dhënë vetëm për pjesëmarrësit me performancën më të mirë. Kjo nënkupton jo vetëm zotërimin e të menduarit kompjuterik, por edhe shkathtësitë për të zgjidhur problemet më sfiduese në kushte konkurruese.